



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:070944  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05638404

C.A.P. nr. 1408/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Besnik Bislimaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K. i P. për M... dhe M..., me adresë rruga "A. D." Nr.1 - Prishtinë, kundër debitorit S. Sh. nga Rahoveci - pronar i biznesit N.N. "Sh...", me seli në fshatin Xëxë – K. e R., për shkak të përmbarimit të dokumentit përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Rahovec, CP.nr.254/2016 të datës 10.01.2023, me datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit K... i P. për M. dhe M..., me adresë rruga "A.. D." Nr.1 - Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Rahovec, CP.nr.254/2016 të datës 10.01.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallë së parë, me aktvendimin e ankimuar CP.nr.254/2016 të datës 10.01.2023, ka vendosur: I. APROVOHET në tërësi si i bazuar propësimi i debitorit S. Sh. nga Rahoveci, i paraqitur kundër Aktvendimit CP.nr.312/2013 të datës 14.05.2013 i lëshuar nga kjo gjykatë. II. HIQET NGA FUQIA Aktvendimi CP.nr.312/2013 të datës 14.05.2013 me të cilin është lejuar përmbarimi. III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditori ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar dhe jo të drejtë të dispozitave materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që të miratohet ankesa e kreditorit, dhe të priset aktvendimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

- ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori K. i P. për M. dhe M., me adresë rruga "A. D..." Nr.1 – Prishtinë, në gjykatën e shkallës së parë, me datë 14.05.2013, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit S. Sh. nga Rahoveci - pronar i biznesit N.N. "Sh...", me seli në fshatin Xëxë – K. . e R., për shkak të ekzekutimit të gjobës administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjakovë, Dega në Rahovec, ka nxjerrë aktvendimi CP.nr.312/2013 të datës 14.05.2013, me të cilin ka lejuar propozimin për përmbartim të kreditorit, kundër të cilit aktvendim debitori në afatin ligjorë ka parashtruar prapsim, ndërsa kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur në prapësimin e debitorit, pas analizimit të shkresave të lëndës, me aktvendimin CP.nr. 312/2013 të datës 12.10.2015, ka vendosur që ta hudhë poshtë prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, debitori ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të udhëzimit administrativ nr. 2008/02, konstatim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar dhe jo të drejtë të dispozitave materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që të miratohet ankesa e debitorit dhe të priset aktvendimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendim AC.nr. 4849/2015 të datës 20.01.2016, ka aprovuar ankesën e debitorit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, pas analizimit të shkresave të lëndës, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, me aktvendimin e ankimuar CP.nr. 254/2016 të datës 10.01.2023, ka vendosur që ta aprovoj prapësimin e debitorit si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallë së parë ka theksuar se Sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr.04/L-139 (i publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.3 të dt.31.01.2013, më tej LPP) në nenin 21 përcaktohen bazat juridike për caktimin e përbarimit, *”Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa me nenin 22 par.1 nënpar.1.2 përcaktohet se *”1. Dokumente përbaruese janë: 1.2. vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”*, ndërsa neni 23 par.2 e përcakton se *”Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...”* Gjykata me verifikimin e Njoftimit (pa numër) të datës 01.09.2006 të lëshuar nga kreditori, në të cilat mbështetet propozimi për përbarim, vërtetoi faktin se ky njoftim nuk i ka cilësitë e dokumentit përbarues, nuk ka *“titulus executionis”*, përkatësisht nuk ka titull ekzekutiv, me arsyetimin se nuk i përmbush kushtet e një akti administrativ siç përcaktohet me nenin 27 par.1 të LPP-së me të cilin rregullohet çështja e përshtatshmërisë së dokumentit përbarimor *”1. Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.*

*Më tej ka theksuar se:* Në këtë njoftim nuk është i shënuar saktë emri i debitorit (mungon numri i biznesit), mungon shuma e pagesës. Kreditori i referohet faturës nr.1365 të datës 01.09.2006 si vendim dhe si faturë, mirëpo ligji e rregullon qartë se çka është vendim administrativ, e çka është faturë (dokument i besueshëm). Dispozitat ligjore neni 22 i LPP-së e përcakton se çka është dokument përbarues – vendim administrativ, ndërsa neni 29 i të njëjtit ligj e përcakton qartë se çka konsiderohet dokument i besueshëm – faturë. Prandaj për gjykatën dokumenti përbarues të cilit i është bashkangjitur edhe fatura nuk është i përshtatshëm për përbarim për dy arsye: 1. Njoftimit – vendimit administrativ i mungon shuma e pagesës. Fatura nr.1365 e datës 01.09.2006 nuk është pranuar nga debitori, në mënyrë që të dihet se kur ka filluar të rrjedhë afati prej 30 ditësh për ta paguar të njëjtën. Në shkresat e lëndës ekziston një dokument *”Shënim për aktivitetin e zyrtarit të hyrave”* i datës 01.09.2006 në të cilën nuk ka nënshkrim nga debitori në mënyrë që të argumentohet se i njëjti e ka pranuar faturën.

*Më tej ka arsyetuar se:* Gjykata analizoj pretendimet në prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, konform nenit 71 par. 1 pika 1.1 të LPP-së, i cili e përcakton se *“dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përbarueshmerisë”*. Në rastin konkret gjykata ka aprovuar prapësimin e debitorit për shkak se Njoftimi i datës 01.09.2006 i nxjerrur nga kreditori nuk ka titull ekzekutiv, ky vendim nuk është nxjerrur në pajtueshmëri me nenin 21, nenin 22 par.1 nënpar.2 dhe nenin 23 par.2 të LPP-së dhe si i tillë nuk e mundëson lejimin e përbarimit. Po ashtu fatura nr.1365 e datës 01.09.2006 në të cilën bazohet propozimi për përbarim nuk është e përshtatshme për përbarim , për shkak se nuk dihet koha e përmbushjes së detyrimit monetar, përkatësisht kur ka rënë në vonesë debitori.

Lidhur me mënyrën e vendosjes, është bazuar në nenin 21, nenit 22 par.1 nënpar.2, nenit 23 par.2, nenit 24 par.3, 27 par.1, nenit 71 par.1 nënpar.1.1, nenit 13 par.5 dhe nenit 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore LPP-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka bazuar në dispozitat e nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit, Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala kreditori me propozim për përmbartim i është referuar dokumentit përmbartimorë njoftimit të datës 01.09.2006, e cila e titullon si aktvendim si dhe faturës me nr. 1365 e datës 01.09.2006 si dokument i besueshëm, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbartimorë, njoftimi i datës 01.09.2006, nuk i përmbushë kushtet ligjore për tu konsideruar dokument përmbartimorë pasi që i njëjti nuk bënë pjesë në nenin 22 par.1 të LPP-së, i cili përcakton se “ Dokumente përmbartuese janë: 1.1. vendimi përmbartues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbartuese; 1.2. vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia). Andaj, në këtë raste njoftimi i kreditorit i cekur si më lartë nuk bënë pjesë në dokumentet përmbartuese dhe si i tillë nuk mund të përmbartohet, ky dokument mund të shërbej në ndenje procedurë tjetër por jo në këtë procedurë e cila udhëhiqet nga parimi i rigozitetit formal. Ndërsa neni 29 i të njëjtit ligj e përcakton qartë se çka konsiderohet dokument i besueshëm – faturë. Prandaj për gjykatën dokumenti përmbartues të cilit i është bashkangjitur edhe fatura nuk është i përshtatshëm për përmbartim për dy arsye: 1. Njoftimit – vendimit administrativ i mungon shuma e pagesës. Fatura nr.1365 e datës 01.09.2006 nuk është pranuar nga debitori, në mënyrë që të dihet se kur ka filluar të rrjedhë afati prej 30 ditësh për ta paguar të njëjtën. Në shkresat e lëndës ekziston një dokument ”Shënim për aktivitetin e zyrtarit të hyrave” i datës 01.09.2006 në të cilën nuk ka nënshkrim nga debitori në mënyrë që të argumentohet se i njëjti e ka pranuar faturën.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *“në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
C.A.P.nr.1408/2023 me datën 30.04.2024

Gjyqtari,  
Besnik Bislimaj, d.v